

Njoftim i përqendrimit me të cilin Teak Kapital B.V. dhe Tangor Kapital S.A. do të fitojnë kontroll të përbashkët mbi NIH VI VOV Holdings S.a.r.l Luksemburg

(lënda nr. 08-157/2023)

Në përputhje të nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), më 26.10.2023, te Komisioni i Mbrojtjes së Konkurrencës është dorëzuar një njoftim i përqendrimit me të cilin **Teak Kapital B.V. (Teak Capital B.V.)**, me seli të regjistruar në Basisweg 10, 1043AP Amsterdam, Holandë (Basisweg 10, 1043AP, Amsterdam, Netherlands) dhe **Tangor Kapital S.A. (Tangor Capital S.A.)**, me seli në Rua de Cabo Verde nr. 37, 4150 159 Porto, Portugali (Rua de Cabo Verde, nr. 37, 4150 159 Porto, Portugal) synojnë të fitojnë kontroll të përbashkët të drejtpërdrejt mbi **NIH VI VOV Holdings S.a r.l (NIH VI VOV Holdings S.a r.l)**, me seli të regjistruar në 12, Boulevardi de la Petrusse, L-2330, Luksemburg, Principata e Madhe e Luksemburgut(124, Boulevard de la Petrusse, L-2330, Luxembourg, Grand Duchy of Luxembourg) nëpërmjet shitblerjes së aksioneve.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre të biznesit

Teak Kapital B.V. është një shoqëri investimesh në sektorin industrial, sektorin financiar, sektorin e pasurive të patundshme, sektorin e arsimit dhe sektorin e shëndetësisë.

Tangor Kapital SA është një shoqëri investimesh në sektorin industrial, sektorin financiar, sektorin e pasurive të patundshme, sektorin e arsimit dhe sektorin e shëndetësisë.

Teak Kapital B.V. dhe Tangor Kapital SA nuk kanë shoqëri të varura të regjistruara në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

NIH VI VOV Holdings S.a.r.l. është kompania udhëheqëse e Grupit VR. Grupi VR është një grup industrial i dedikuar, nga njëra anë, në prodhimin e qelqit të presuar për prodhimin e dyerve të qelqit për lavatriçe dhe tharëse, eenëve për pjekje, si dhe prodhimin dhe shitjen e kallëpeve të çelikut për komponentët e ndriçimit të automobilave.

Sipas parashtresit të njoftimit, tregu i relevant i produkteve mund të përkufizohet si (i) prodhimi i qelqit të presuar për industri dhe (ii) prodhimi dhe shitja e kallëpeve të çelikut për komponentët e ndriçimit të automobilave. Për të dy tregjet gjeografike, shtrirja e saktë gjeografike është më e gjerë se ajo kombëtare. Për sa i përket tregut të prodhimit të xhamit të presuar, tregu është global. Nga ana tjetër, për sa i përket tregut të prodhimit dhe shitjes së kallëpeve të çelikut për komponentët e ndriçimit të automobilave, tregu është në nivelin EEZ.

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim te Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të dërgohen edhe me faks: 02 3296 466, në adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54, Shkup ose me email: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë te Komisioni në afat prej 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

31.10.2023

Shkup

